



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:050949

Datë: 28.07.2021

Numri i dokumentit: 02038068

C.nr.1016/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni civil, me gjyqtaren Mirvete Alidemi dhe bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike të paditësit A. B. nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Milot Spahiu avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, të cilën me autorizim e përfaqëson Burim Maliqi, Zyrtar Ligjor në Zyrën e Avokatit të Komunës së Gjilanit, me objekt kontesti kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar, vlera e objektit: 1,439.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe jopublik (për shkak të pandemisë Covid -19) të mbajtur me datë 18 Qershor 2021, mori këtë;

A K T G J Y K I M

I.MIRATOHET kërkesëpadia e paditësit A.B. nga Gjilani dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 980 €, në emër të kompensimit të ushqimit ditor , për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 18.04.2021, respektivisht për 490 ditë të pranisë në punë dhe shumën e të hollave prej 459€ në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune në vlerë të një page baze, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,439.00 €, duke e llogaritur kamatën prej 8% nga data 10.04.2020 (data e dorëzimit të padisë në gjykatë) e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 270 euro, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

A r s y e t i m

Fillimisht paditësit, A. B. nga Gjilani, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim Milot Spahiu, avokat nga Gjilani, në këtë Gjykatë ka paraqitur padi për pagesën e shpërblimit jubilar dhe kompensimin e ushqimit ditorë në shumë të përgjithshme prej 1,617.00 euro. Por në shqyrtimin gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e ka bërë rregullimin e padisë në kuptimin objektiv , ashtu që ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën, që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave prej 980 €, në emër të kompensimit të ushqimit ditorë, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 18.04.2021, respektivisht për 490 ditë të pranisë në punë dhe shumën e të hollave në lartësi prej 459€, në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune në vlerë të një page baze, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,439.00€, duke e llogaritur kamatën prej 8% nga data 10.04.2020 (data e paraqitjes së padisë në gjykatë) e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor, meqë më parë kishte kërkuar nga organi përkatës për një pagesë dhe kompensim të tillë, por nga e njëjta nuk kishte marrë përgjigje. Përfaqësuesi i paditëses ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar ato edhe atë 104 € për

përpilimin e padisë, 31 € për taksën gjyqësore si dhe 135 € për përfaqësim në një seancë gjyqësore.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës, në përgjigje në padi, gjatës shqyrtimit gjyqësor dhe në shpjegimet përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me ligj, duke theksuar se Gjykata Themelore në Gjiilan nuk ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin, meqë e kompetencës lëndore është Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative e po ashtu ka theksuar se Komuna e Gjiilanit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, meqë nënshkrues të Kontratës së lartcekur janë MASHT-i/ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/ dhe SBASHK-u/ Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës/ dhe se kontrata kolektive nuk prodhon efekte juridike për të paditurën, ngase e paditura nuk është nënshkruese e Kontratës. Pagat jubilar sipas Kontratës Kolektive të Arsimit mund të realizohen pas çdo 10 viteve dhe se afati i realizimit të kësaj kërkesë është 30 ditë nga koha e të drejtës për këtë kompensim, ndërsa në rastin konkret kemi tejkallim të afatit ligjor të realizimit të kësaj kërkesë ndërsa nuk kemi ndonjë shkresë që paditësja në afat prej 30 ditëve ka kërkuar realizimin e kësaj kërkesë.

Gjykata analizoi secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe vërtetoi se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar me ligj, ashtu që Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit duke e detyruar të paditurën që paditësit, t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 980 €, në emër të kompensimit të ushqimit ditor për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 18.04.2021, respektivisht për 490 ditë të pranisë në punë dhe shumën e të hollave në prej 459€, në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune në vlerë të një page baze, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,439.00 €, duke e llogaritur kamatën prej 8% nga data 10.04.2020 (data e paraqitjes së padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

Kërkesat e paditësit bazën ligjore e kanë në nenin 35, paragrafi 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë / *Kontrata nr. 24 e dt. 18.04.2017*/ ngase në nenin përkatës në është përcaktuar se: *Punëtorët (anëtarë të SBASHKUT-ut) në vitin jubilar të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 10 vite të përvojës së punës shpërblimin 50% të një page baze, për 20 vite të përvojës së punës shpërblimin prej 75% të një page baze, për 30 vite të përvojës së punës shpërblimin në vlerë të një page baze, ndërsa në bazë të nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive është përcaktuar se „të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy /2/ € për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.* Gjykata konstaton se edhe me Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 në nenin 35 janë përcaktuar të njëjtat kushte dhe detyrime për të paditurën.

Në fakt në mes të palëve ndërgjyqësore nuk është kontestues fakti se paditësi është Mësimdhënës i lëndës së Skulpturës në Shkollën e Artit Pamor “Adem Kastrati” në Gjiilan, ngase një fakt i tillë vërtetohet nga Vërtetimi me nr.45/2019 i dt.12.12.2019 i lëshuar nga Shkolla e Artit Pamor “Adem Kastrati” në Gjiilan, kurse nga lista e pagave të lëshuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës , vërtetohet se paga bazë e paditësit është 459€, ashtu që në mbështetje të nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e duke u mbështetur në përvojën e punës mbi 30 vjeç i takon kompensimi i një page baze në lartësi prej 459€ dhe nga vërtetimi me nr.477 i dt.15.10.2008 lëshuar nga SHMU “Abdulla Krasnica”- Presheva” në fshatin Koretin Komuna e Kamenicës, nga Vërtetimi me numër 13,03.2020 i

lëshuar nga SHMAT “Arbëria ne Gjilan si dhe nga Vërtetimi me numer 29 i datës 14.10.2008 i lëshuar nga SHMT “Mehmet Isai” ne Gjilan është përcaktuar se paditësi ka përvojë të punës mbi 30 vite.

Po ashtu nga vërtetimi me nr.të prot.84/2020 i datës 09.03.2020 dhe nga Vërtetimi ne numër te prot.32/2021 i datës 17.06.2021 vërtetohet se paditësi për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 18.04.2021 ka qenë i pranishëm në punë për 490 ditë, ashtu që në mbështetje të nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura duhet t’ia kompensoj shpenzimet e ushqimit ditor nga dy/2/ euro në ditë , respektivisht në lartësi prej 980 €.

Po ashtu Gjykata konstaton se paditësi fillimisht kërkesën për kompensim e ka adresuar te e paditura, fakt që vërtetohet nga Formulari apo ankesa së bashku me kërkesën për kompensimin e pagës jubilarë, por që e paditura ka heshtur lidhur me këtë kërkesë dhe fare nuk i është përgjigjur paditësit.

Sipas pretendimeve të palëve ndërgjyqësore nuk ka qenë kontestuese lartësia prej 2 euro e pagesës së ushqimit gjatë pranisë në punë si dhe prania e mësimdhënësit në punë deri më datën 18.04.2020, por kontestuese sipas të paditurës mbeten faktet nëse Kontrata Kolektive e lartcekur prodhon efekt juridik për të paditurën, meqenëse nuk është nënshkruar nga ana e saj e po ashtu ishte kontestues edhe vërtetimi mbi ditët e pranisë pas kalimit të afatit të kontratës kolektive , gjegjësisht pas datës 18.04.2020.

Lidhur me pretendimet e të paditurës gjykata arsyeton se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat e Rregullta/ Ligji nr. 06/L – 054 në nenin 12.1 decidivisht është përcaktuar se „*Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe*. Kurse Departamenti për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat gjykon çështjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktin administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtorëve që sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës/ Ligji Nr. 03/L-149/ marrëdhënia juridike e të cilëve rregullohet me këtë Ligj, të cilët sipas nenit 82 të Ligjit ndjekin procedurën e realizimit të së drejtës së tyre së pari në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrësia, pastaj i drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës e më pastaj me padi i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamentit për Çështje Administrative për hapjen e Konfliktit Administrativ, kurs siç dihet të punësuarve në sektorin e arsimit ju garantohet mbrojtje ligjore në mbështetje të Ligjit të Punës së Kosovës.

Gjykata po ashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditësit edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/*Kontrata nr.24. e datës 18.04.2017/*, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimin e të paditurës ku ka theksuar se paditësi fillimisht nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative para se të paraqes padi në gjykatë, mirëpo për gjykatën edhe ky pretendim i të paditurës është i pabazuar, pasi që, në bazë të shkresave të lëndës dhe provave të administruara, përkatësisht Formularit për kërkesë apo ankesë me nr. protokollit 05-610/01-0009574/20, të datës 27.01.2020 dhe Kërkesës për

kompensimin, e po të njëjtës datë, rezulton se paditësi fillimisht iu ka drejtuar me kërkesë të paditurës për realizimin e të drejtës së tij, por e paditura nuk iu ka përgjigjur kërkesës së paditësit. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se meqë e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar konventa ndërkombëtare dhe me ligj, në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësi brenda afatit të cekur më lartë mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore për kërkesat të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës në para, mirëpo kjo nuk nënkupton se paditësi nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike të e paditura ashtu siç pretendon e paditura, kjo ngase e paditura ka pas obligim ligjor që të përmbush detyrimin e saj ndaj paditësit në shumën e kërkuar dhe të aprovuar me kërkesëpadi në bazë të dispozitave të cekura më lartë.

Detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës dhe kamatëvonesës prej 8% në vit është gjykuar nga Gjykata në mbështetje të nenit 382 të LMD/ Ligji nr. 04/L-077 i datës 10 maj 2012, në të cilën dispozitë është përcaktuar se „*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitor, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.*

Ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, Gjykata e bazoi në nenin 452.1 të LPK-së, duke marr parasysh suksesin e paditësit në kontest, ashtu që e detyroi të paditurën që t'ia kompensoj paditësit shpenzimet në lartësi prej 270€, në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi edhe atë për përpilimin e padisë shumen prej 104€, taksa gjyqësore në lartësi prej 31€ dhe për një përfaqësim gjyqësor të avokatit 135 €.

Nga të cekurat më lartë, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni civil
C.nr.1016-2020, më datën 18 Qershor 2020

G j y q t a r j a,
Mirvete Alidemi

Udhëzim mbi Mjetin Juridik: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:050949
Datë: 28.07.2021
Numri i dokumentit: 02038068